



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË**  
**DHËNAVE PERSONALE**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**  
**DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE**  
**SIGURISË PUBLIKE**

Nr. 1855/5 prot.

Tiranë, më 06.10.2025

**REKOMANDIM**

**Nr. 45, datë 06.10.2025**

**PËR KONTROLLUESIN “SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË, (TLAS)”**

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”<sup>1</sup> (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, (TLAS)” (në vijim, “Kontrolluesi”),

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 136, datë 16.07.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është një organizatë jofitimprurëse, e regjistruar si “Qendër”, në regjistrin e OJF-ve, me Vendimin nr. 346, datë 18.12.2006, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

---

<sup>1</sup>Ligji aktual në fuqi, i cili shfuqizon ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Për këtë arsye, orientojmë të gjithë subjektet e ligjit, të përditësojnë bazën ligjore në të gjitha aktet rregullatore.

TLAS ka si objekt të veprimtarisë së saj, ofrimin e shërbimeve ligjore falas për shtresat në nevojë, si dhe kontribuon në ndërgjegjësimin e shoqërisë shqiptare mbi shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe përmirësimin e sistemit ligjor.

2. Konstatohet se Kontrolluesi, në funksion të veprimtarisë së tij, dhe përmbushjes së detyrave ligjore, përpunon të dhëna personale për personat “përfitues”, sipas kategorive: “Emër”, “Atësia”, “Mbiemër”, “Data e lindjes”, “Nr. i identifikimit”, “Gjinia”, “Vendlindja”, “Shtetësia”, “Adresa”, “Gjendja Civile”, “Të dhëna ekonomike dhe financiare”, “Çertifikatë personale”, “Çertifikatë familjare” dhe “Çertifikatë martese”.

Përpunimi i të dhënave personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave “përfitues” kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike, të administruara në një bazë të të dhënave të dedikuar, e krijuar posaçërisht për këtë qëllim.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, si dhe nga verifikimet në terren, konstatohet se, popullimi dhe administrimi i bazës elektronike të të dhënave me të dhënat personale të mësipërme, realizohet nga këshilltari paraligjor dhe avokatët e zyrës, të cilët aksesojnë me anë të një kodi unik personal që lejon hyrjen në të dhënat e ruajtura në mënyrë elektronike.

Ky mekanizëm i kontrollit të aksesit është vendosur me qëllim që të garantojë ruajtjen, integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, duke minimizuar çdo rrezik të mundshëm të qasjes së paautorizuar, manipulimit apo keqpërdorimit të informacionit, në përputhje me parashikimet e pikës 6, të nenit 6 dhe nenit 28 të Ligjit.

3. Kontrolluesi ka vënë në dispozicion të grupit të hetimit administrativ, rregulloren e brendshme të qendrës TLAS. Nga shqyrtimi i rregullores së vendosur në dispozicion, konstatohet se në pikën IV “Politikat e punës me klientin”, është parashikuar një seksion i veçantë me titull “Ruajtja dhe administrimi i të dhënave personale të klientëve”.

Nga analizimi i përmbajtjes së këtij seksioni, konstatohet se në të, parashikohen rregulla të përgjithshme dhe jo specifike mbi kategoritë dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, afatet e ruajtjes së të dhënave, masat teknike e organizative për administrimin e tyre, etj., në kundërshtim me parashikimet e pikës 6, të nenit 6 dhe nenit 28 të Ligjit. Në mënyrë të veçantë, vërehet se në këtë rregullore:

- Nuk janë përcaktuar qartë kategoritë specifike të të dhënave personale që përpunohen, përfshirë ndarjen e të dhënave personale nga ato sensitive, të cilat kërkojnë masa mbrojtjeje më të forta;
- Mungojnë udhëzime të hollësishme mbi metodat dhe praktikat konkrete të përpunimit të të dhënave personale, si mënyra e mbledhjes, regjistrimit, ruajtjes dhe asgjësimit të tyre;

- Nuk janë përcaktuar në mënyrë konkrete masat teknike dhe organizative të implementuara për garantimin e sigurisë së të dhënave, si p.sh. enkriptimi, kontrolli i aksesit, regjistrimi i hyrjeve dhe daljeve në sistemet e informacionit, apo procedurat për menaxhimin e incidenteve të sigurisë;
- Nuk ka një përcaktim të qartë të afateve të ruajtjes së të dhënave personale, gjë që është thelbësore për të respektuar parimin ligjor të kufizimit të ruajtjes dhe për të shmangur mbajtjen e të dhënave më gjatë se sa është e nevojshme për qëllimet e përpunimit;
- Nuk janë përmendur procedura konkrete për asgjësimin apo anonimizimin e të dhënave pas përfundimit të periudhës së ruajtjes, si dhe nuk ka udhëzime mbi mënyrën e trajtimit të kërkesave për fshirje apo korrigjim të të dhënave nga ana e subjekteve të të dhënave.

Mungesa e përcaktimeve të qarta të rregullave të mësipërme, është në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në nenet 6 dhe 28 të Ligjit. Këto dispozita ligjore kërkojnë që çdo Kontrollues i të dhënave të përcaktojë dhe zbatojë masa të përshtatshme teknike dhe organizative, të cilat garantojnë përpunimin e të dhënave personale në mënyrë të sigurt dhe të përputhshme me parimet e ligjit, duke ruajtur integritetin, konfidencialitetin dhe disponueshmërinë e tyre.

Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim që të garantojë mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale të subjekteve përfitues në këtë qendër në përputhje me nenet 6 dhe 28 të Ligjit.

4. Gjithashtu, konstatohet se, Kontrolluesi nuk disponon rregullore “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi kategoritë e të dhënave personale, mënyrën e përpunimit të të dhënave, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve, etj., sipas parashikimeve të nenit 28 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të tij.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një rregulloreje “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën duhet të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 28 të Ligjit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

5. Gjatë hetimit administrativ të zhvilluar në ambientet e Kontrolluesit, lidhur me përpunimin të dhënave personale, nga ana e përfaqësuesve të Kontrolluesit deklarohet se dokumentacioni fizik ruhet për një periudhë 10 vjeçare dhe me kalimin e këtij afati, ky dokumentacion asgjësohet, ndërsa të dhënat personale të administruara elektronikisht në bazën e të dhënave ruhen që nga fillimi i funksionimit të TLAS.

Nga analizimi i rregullores së brendshme, si dhe akteve të tjera rregullatore të vendosura në dispozicion, konstatohet se në asnjë dispozitë të tyre nuk janë përcaktuar afate konkrete në lidhje me kohën e ruajtjes së të dhënave personale. Gjithashtu, nga ana e Kontrolluesit nuk është vendosur në dispozicion asnjë procesverbal asgjësimi lidhur me dokumentacionin e administruar gjatë veprimtarisë.

Për sa më sipër, konstatohet se Kontrolluesi nuk ka marrë masa konkrete për përcaktimin e afateve konkrete për ruajtjen dhe shkatërrimin e të dhënave personale, duke patur në vëmendje rëndësinë e garantimit të sigurisë së informacionit dhe mbajtjen e dokumentacionit për aq kohë sa është i nevojshëm për qëllimin për të cilin është grumbulluar, në kundërshtim me parimin e ruajtjes në kohë, sipas pikës 5, të nenit 6 të Ligjit.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi nuk ka parashikuar afate për kohën e ruajtjes së tyre, në kundërshtim me parimin e mbrojtjes së të dhënave personale, sanksionuar në pikën 5, të nenit 6, të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar.

Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimin e pikës 5, të nenit 6 të Ligjit. Gjithashtu, në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm.

6. Kontrolluesi nuk ka hartuar dhe publikuar “*Politikat e Privatësisë*” në faqen zyrtare të internetit <https://www.tlas.org.al/>, duke mos përmbushur kështu detyrimin ligjor për të garantuar transparencën dhe informimin e subjekteve të të dhënave, të cilët aksesojnë dhe ngarkojnë të dhëna personale në të.

Mospërmbushja e këtij detyrimi bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 të Ligjit, i cili përcakton se çdo subjekt i të dhënave duhet të informohet në mënyrë të qartë dhe të plotë për qëllimin e mbledhjes dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave të tij personale, kategoritë e të dhënave personale, personat që do t’i përpunojnë apo përfitojnë akses në këto të dhëna, afatet e ruajtjes së tyre, si dhe për të drejtat që ai gëzon sipas legjislacionit përkatës, përfshirë të drejtën për akses, korrigjim, kundërshtim dhe fshirje.

Mungesa e politikave të qarta të privatësisë cenon parimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë në përpunimin e të dhënave personale dhe rrit rrezikun për shkelje të privatësisë dhe të drejtave themelore të individëve. Subjektet që aksesojnë faqen ose ngarkojnë të dhëna personale në të, nuk informohen për masat teknike dhe organizative të sigurisë që aplikohen për mbrojtjen e të dhënave, duke krijuar një

boshllëk të rëndësishëm në respektimin e standardeve ligjore dhe etike për mbrojtjen e privatësisë.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë, si dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërmblidhja e këtij detyrimi nga Kontrolluesi mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave. Informimi sipas përcaktimeve të nenit 13 të Ligjit, duhet të aplikohet për çdo proces përpunimi të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, që kryen Kontrolluesi.

7. Kontrolluesi ka vendosur në dipozicion të grupit të hetimit administrativ, kontratë shërbimi të nënshkruar me “Innovatech” sh.p.k, me objekt: *“Ofrim i hostimit të faqes së internetit tlas.org.al dhe mirëmbajtja e përgjithshme e pajisjeve elektronike”*.

Nga shqyrtimi i kontratës së mësipërme, rezulton se, në të, nuk janë reflektuar rolet mes palëve si kontrollues dhe përpunues të të dhënave personale, si dhe detyrimet e përgjegjësitë që secila palë duhet të ketë gjatë procesit të përpunimit të të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet e nenit 26 të Ligjit.

Gjithashtu, mospërfshirja e këtyre elementeve në kontratë është në kundërshtim edhe me dispozitat e Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit *“Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”*, i ndryshuar (në vijim, *“Udhëzimi nr. 19”*), në të cilin gjendet modeli standard i kontratës që duhet të përdoret në raste të tilla, si dhe përcakton elementët dhe garancitë minimale që duhet të përmbajë kjo marrëveshje, në mënyrë që të garantohet përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, të gjitha detyrimet e sanksionuara në nenin 26 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, duhet të jenë të përfshira në kontratën dhe/ose aneks kontratën e hartuar dhe nënshkruar mes kontrolluesit dhe përpunuesit. Çdo kontratë përpunimi, që ka për qëllim delegimin e përpunimit të të dhënave personale duhet të përmbajë dispozita që vendosin rregulla për përpunimin e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi. Çdo kontratë e tillë duhet të parashikojë masat që duhet të marrë përpunuesi për të siguruar e garantuar mbrojtjen e të dhënave, si dhe hapat që do të ndërmerren në rast cenimi të të dhënave, me qëllim që të sigurojë paprekshmërinë e tyre, në çdo hallkë të këtij përpunimi.

8. Gjithashtu, konstatohet se nga ana e Kontrolluesit nuk janë marrë masa të përshtatshme për zhvillimin dhe dokumentimin e programeve të trajnimit për punonjësit që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale. Më konkretisht, mungojnë evidenca apo certifikata që vërtetojnë se punonjësit janë trajnuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të strukturuar mbi legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të

dhënave personale, si dhe mbi politikat dhe procedurat e brendshme që lidhen me këtë fushë.

Për sa më sipër, konstatohet se Kontrolluesi nuk ka marrë masa në zbatim të detyrimeve që parashikohen në germa “c” dhe “ç”, të pikës 1 të nenit 34 të Ligjit dhe Udhëzimi nr. 47, datë 14.09.2018 i Komisionerit “*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 47*”), i cili përcakton qartë se Kontrolluesi është i detyruar të sigurojë që personeli i përfshirë në përpunimin e të dhënave personale të jetë i trajnuar dhe i ndërgjegjësuar për detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni përkatës.

Moszbatimi i këtij detyrimi jo vetëm që përbën një shkelje të kuadrit rregullator në fuqi, por gjithashtu rrit potencialisht rrezikun për përpunim të të dhënave personale në mënyrë të paautorizuar, të pasigurt ose në kundërshtim me parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe proporcionalitetit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, bazuar në germa “c” dhe “ç”, të pikës 1 të nenit 34 të Ligjit dhe Kreun IV, të Udhëzimit nr. 47, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura sipas nevojave dhe proceseve të punës të Kontrolluesit dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim ndërgjegjësimin e punonjësve, të cilët për shkak të proceseve të punës, janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare.

Në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesit i është lënë afat të depozitojë pretendimet me shkrim, referuar procesverbalit të hartuar nga ana e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Kontrolluesi ka dërguar në rrugë postare procesverbalin e nënshkruar nga ana e përfaqësuesit të tij dhe nuk ka paraqitur pretendime me shkrim në lidhje me gjetjet e konstatuara nga grupi i hetimit administrativ.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara.

Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

## PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 13, 26, 28, 34, 81, 82, 83 dhe 84 të Ligjit,

## REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, të marrë masa për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjitha proceset e përpunimit, në përputhje me pikën 5, të nenit 6 të Ligjit. Në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm;
2. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 28 të Ligjit, të hartojë rregulloren “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj.;
3. Kontrolluesi, të marrë masa për të publikuar “*Politikat e Privatësisë*” në faqen e internetit <https://hotlinealbania.org>, me qëllim informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit;
4. Kontrolluesi, të marrë masa për të rishikuar marrëveshjet e bashkëpunimit me përpunuesit, duke specifikuar rolet, përgjegjësitë dhe detyrimet midis palëve, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 26 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit;
5. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në ghermat “c” dhe “ç”, të pikës 1 të nenit 34 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, në përputhje me proceset përpunuese që ata kryejnë gjatë veprimtarisë së tyre;
6. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
  - (i) vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikën 5 më sipër;
  - (ii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikën 1 dhe 2 më sipër;
  - (iii) brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 3 dhe 4 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

7. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;

8. Në rast mospërmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri, bazuar në germën “a”, pika 2, e nenit 83 të Ligjit, paralajmëron kontrolluesit ose përpunuesit se veprimet e përpunimit mund të rezultojnë në mosplotësim të dispozitave ligjore dhe u jep atyre rekomandime lidhur me përputhshmërinë me ligjin. Në rast shkeljesh serioze ose të qëllimshme të dispozitave ligjore, Komisioneri vepron sipas neneve 92, 93 dhe 94 të Ligjit, për vendosjen e sanksioneve administrative në përputhje me nenet përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, në mënyrë të tillë që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 06.10.2025.

## **KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**